



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 93/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosja me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjekti politik Lëvizjes Vetëvendosja (LVV)

Arsyetim

Subjekti politik LVV ka parashtruar ankesë në PZAP me datën 23.01.2011 në të cilën pretendon se me datë 23.01.2011, në QV 1112B, në Shkollën Fillore “Hivzi Sulejmani” në Mitrovicë, numri i votuesve në këtë QV për zgjedhjet e 12.12.2010 kanë qenë 2933 ndërsa për zgjedhjet e 23.01.2011 numri i votuesve ka qenë 3202. Me këtë rast pretendohet se është bërë shkelja e nenit 64.2 pika të LZP-së

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankesit ose udhëzime se ku

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP i beri nje kërkesë për konfirmim me datë 24.01.2011 KQZ-se lidhur me A93/2, që ti siguroj Listën e Votuesve respektivisht numrin e votuesve në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV). për të konfirmuar numrin e votuesve në QV nr.1112B shkolla fillore “ Hivzi Sylejmani” në Mitrovicë. KQZ me datë 25.01.2011 është Përgjigjur në Kërkesën për Konfirmim të parashtruar nga PZAP-i, të cilës iu është bashkangjitur LPV.

PZAP analizoi dhe shqyrtoi LPV për QV 1112B dhe erdhi në përfundim se LPV mbetet unike për tërë procesin zgjedhor që nga momenti i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit dhe si e tillë është miratuar kjo listë përfundimtare, kështu që numri i saktë i votuesve në të dy proceset e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës ka qenë 3102 votues dhe jo siç është pretenduar në ankesë përkatësisht 2933 votues per zgjedhjet e 12.12.2010 dhe 3202 votues per zgjedhjet e 23.01.2011. Si rrjedhim PZAP nuk gjeti prova se është bërë shkelja e nenit 64.2 për te vërtetuar shkeljen e pretenduar dhe për këtë arsye vlerësoi se pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë te pabazuara. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 93/2011 më datën 26.01.2011.

